

Shkollimi i mirë për nxënësit e posardhur është përgjegjësi e tërë shkollës

Kontrollimi tregon:

- Shkollat nuk e planifikojnë, realizojnë dhe përshtatin shkollimin për nevojat dhe parakushtet e nxënësve të posardhur, në ndonjë shkallë të madhe.
- Shkollat punojnë në shkallë të ulët për tu dhënë nxënësve besim në aftësitë e tyre, motivacion dhe influencë

Evidencim më i mirë dhe strategji të përbashkëta

Nxënësit e posardhur nuk ndeshen nga një mësimdhënie që karakterizohet nga stimulimi, sfidat dhe përshtatshmëria individuale, në ndonjë shkallë të lartë.

Nxënësit e posardhur kanë përvoja dhe dituri të ndyshme në lëndët mësimore kur ata fillojnë në shkollën suedeze. Disa nga shkollat mundohen për të gjetur se çka dinë këta nxënës, por asnjëra nga shkollat nuk bën ndonjë hulumtim sistematik. Fillimi zakonisht shfytëzohet për të mësuar suedishten e më pak lëndët e tjera. Ky kontroll tregon ndihmë mësimi në gjuhën amtare, aty ku ka, dhe ndihma të veçantë për nxënës, e bëjnë jetën e tyre dhe nuk janë të koordinuara me mësimin tjetër.

Mësimi varet shumë nga kontributi individual i mësuesit. Shumica e shkollave të kontrolluara nuk kanë një qasje të plotë dhe nuk kanë ndonjë organizim për tu dhënë mësimdhënësve parakushte që nxënësve të posardhur tu jepet një mësim i mirë.

Për tu dhënë nxënësve të posardhur një mësimdhënie të mirë, shkollat kanë nevojë:

Të bëjnë një evidencim sistematik i diturive dhe përvojave të nxënësve.

Të përshtatin mësimin nga ajo që rezulton nga evidenca e diturive të nxënësve.

Tu japin nxënësve të posardhur ndihmë të nevojshme në mësim në gjuhën amtare

Të hartojnë strategji të përbashkëta. Mësimi i gjuhës bëhet në të gjitha lëndët, të gjithë mësuesit duhet të jenë mësues gjuhe.